




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	03
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	01-3383/15
Data Datum Date	19.10.2015
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	19.10.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	znj. Fatime SHALA Menaxhere Prokurimi – Komuna e Mitrovicës
CC:	z. Agim BAHTIRI Kryetar - Komuna e Mitrovicës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin " Furnizimi me fidanë të Mjadrës dhe material për ngritjen e pemishtes prej 0.1 ha"



E nderuara znj. Shala,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " **Furnizimi me fidanë të Mjadrës dhe material për ngritjen e pemishtes prej 0.1 ha**" me numër prokurimi: 642-15-067-121:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Furnizimi me fidanë të Mjadrës dhe material për ngritjen e pemishtes prej 0.1 ha**" me numër prokurimi: 642-15-067-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Komuna e Mitrovicës si Autoritet Kontraktues, përmes Zyrës për Prokurim ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull " **Furnizimi me fidanë të Mjedrës dhe material për ngritjen e pemishtes prej 0.1 ha**" me numër prokurimi: 642-15-067-121, të cilat janë publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.06.10.2015. Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në të dhëna të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 06.10.2015 tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesionale nën-pika 2. **Ka kërkuar që Fidanet e kultivuara të jenë Polka dhe Williamet**, kërkesë kjo e cila konsiderojmë se bien ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik.

Bazuar në legjislacionet në fuqi për Prokurim Publik me përcaktimin e emrit të prodhuesit të këtyre mallrave, mund të favorizohen prodhuesit e caktuar dhe në të njëjtën kohë diskriminohen prodhuesit tjetër. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që produkti të jetë i kualitetit të lartë dhe mund ti referohet një standardi vendor, Europian ose ndërkombëtar, por nuk lejohet assesit të kërkohet emërtimi i të këtyre mallrave.

Njësia kërkuese pranë Autoritetit kontraktues duhet të ketë kujdes që me rastin e formulimit të specifikimeve teknike të mos formulojë specifikime favorizuese për prodhues të caktuar e në të njëjtën kohë ti diskriminojë Operatorët tjerë ekonomik, si dhe të mos caktoj kërkesa të cilat do ti pengonin operatorët ekonomik për të dorëzuar tenderët e tyre.

Pa ashtu AKK gjatë shfletimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar se në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknike dhe profesionale nën-pika 3. **Ka kërkuar Furnizuesi ti ketë së paku dy referenca për furnizime të njëjta.** Sipas Legjislacioni në fuqi për Prokurim Publik, një Autoritet Kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kriterëve të përzgjedhjes të kërkojë si dëshmi kontrata dhe referenca me të cilat do ta vërtetonte Kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse e vendos një kërkesë të tillë, për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të OE-ve, atëherë detyrimisht këto kontrata dhe referenca duhet ti kërkojë në tri vitet e fundit (2012,2013 dhe 2014) .

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka analizuar me kujdes pjesën e specifikimeve teknike për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues në pjesën përfundimtare të tabelës ka shënuar si Vërejtje: **Kjo para masë është vetëm për 0.1 HA (DHJETË ARI) kurse komuna do të furnizohet më shumë varësisht prej çmimeve të ofruara nga operatori ekonomik dhe se**

sa mjete do ti ketë në dispozicion. AKK konsideron se furnizimet duhet të jenë në pajtim të plotë me specifikimet teknike të parashtruara në këtë Dosje të Tenderit dhe se Autoritetit Kontraktues assesi nuk i lejohet që të tejkaloj sasinë e parashikuar sipas procedurës së shpallur.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 28 Specifikimet teknike, nenin 69 Aftësitë teknike dhe/ose profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 dhe nenin 9 Funksionet e Njësisë së Kërkesës të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

QASOVA *